


Recension

KONTRIBUTI I PROFESOR ZYMER NEZIRIT NË GJURMIME TË EPOSIT TË KRESHNIKËVE NË BALLKAN

Zymer Ujkan Neziri, *Studime për folklorin, V, Gjurmime të Eposit të Kreshnikëve në Ballkan: Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa vise të Ballkanit*, 538 faqe, (Tiranë, Akademia e Studimeve Albanologjike, 2023), ISBN 978-9928-394-19-4.



Trashëgimia kulturore gojore shqiptare, pak nga pak, po zë vendin e vet në programet e rendit parësor të UNESCO-s për pasuritë elitare të njerëzimit. Në vetvete, eposi shqiptar përfaqëson një prej trashëgimive folklorike më të hershme dhe si i tillë ka qenë objekt vëmendjeje

shkencore nga studiues të vendit dhe të huaj, të paktën që nga fillimi i shekullit XX. Përmendim me vlerësim dhe nderim artikujt dhe studimet e profesorëve Qemal Haxhihasani, Ramadan Sokoli, Alfred Uçi, Demush Shala, Gjergj Zheji, Jorgo Panajoti, Mark Tirta, Anton Berisha, Shaban Sinani etj.

Midis këtyre studiuesve të përkushtuar ka zënë vend plotësisht të qëndrueshëm e të merituar edhe prof. Zymer Neziri, studiues me formim e interesa të gjerë, i cili ka krijuar profilin e vet serioz të një mbledhësi dhe studiuesi të apasionuar të krijimtarisë folklorike, në veçanti në fushën e epikës, në Eposin e kreshnikëve, si një ndër monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë sonë shpirtërore,

duke na dhënë një kontribut të çmuar.

Krijimtaria e tij studimore është e shumtë, por në veçanti përmendim: *Epika legjendare e Rugovës*, (1997); antologjia *Këngë të kreshnikëve*, (1999, 2001, 2003, 2009, 2011, 2013); monografia *Poetika e krahasimit. Figura e krahasimit në këngët tona lirike të dashurisë* (2004); përmbledhja *Studime për folklorin, I: Eposi i Kreshnikëve dhe epika historike* (2006); përmbledhja *Studime për folklorin, II: Epika gojore dhe etnokultura* (2008); vëllimi *Epika legjendare e Rugovës, I* (2009); vëllimi *Epika legjendare e Rugovës, II* (2011); përmbledhja *Studime për folklorin, III: Eposi i Kreshnikëve* (2018); *Studime për folklorin, IV, Eposi i Kreshnikëve në Ballkan: Indeksi i Projektit E5, 2012-2016. Dëshmi dokumentare për UNESCO, 2021*, dhe së fundmi, *Studime për folklorin, V, Gjurmime të Eposit të Kreshnikëve në Ballkan: Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa vise të Ballkanit*, 2023.

Krijimtaria e tij studimore, vjelja në terren e materialit folklorik, por dhe vlerësimet që japin studiues të ndryshëm në lidhje me të, bëjnë të krijosh një panoramë të plotë e të qartë për kontributi e tij të veçantë.

Ka dhënë ndihmesë me shumë vlerë në lëmë të epikës legjendare, në studimin e eposit legjendar shqiptar, duke mbledhur në terren dhe arkiva, duke botuar shumë. Ka gjurmuar e studiuar dukuritë e kulturës në kompleksitet, ashtu siç gjenden të sinkretizuara edhe në jetën e në trashëgiminë që populli i ka ruajtur dhe i ka zhvilluar ndër shekuj.

Punimet e tij në lëmin e folkloristikës krijojnë bindjen e patundur se folklori është jo vetëm autobiografi e histori e kombit, jo vetëm vetësanksionim artistik dhe vetëmbrojtje e identitetit kombëtar, jo vetëm dëshmi e aftësisë krijuese dhe e mençurisë së krijuesit, por edhe lëndë, edhe mjet njëkohësisht.

Në gjithë kontributin e tij, studime, botime, kumtesa, referate, ka arritur të bëjë trajtime dhe përgjithësime të argumentuara. Kudo ndihet qartë kujdesi dhe shqetësimi i vazhdueshëm për të nënvizuar pasurinë, larminë, bukurinë dhe origjinalitetin e folklorit shqiptar, pasi qëllimeve kombëtare u shërbehet përmes të vërtetave shkencore dhe se një “shkencë atdhetare” funksionuese pa mendimin kritik s’mund të ketë kurrfarë dobie.

Me veprën *Gjurmime të eposit të kreshnikëve në Ballkan* (Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa vise të Ballkanit), prof. Z. Neziri plotëson ndjeshëm panoramën, se si vitet e fundit janë shënuar disa hapa me rëndësi thelbësore në studimin dhe njohjen e repertorëve të këngës epike shqiptare, si thellimi i punës në terren dhe botimi i koleksioneve të ndryshme, që kanë shpalosur një traditë të gjallë në një zonë më të gjerë territoriale, jo vetëm në Shqipëri e Kosovë, por edhe në zona të konsiderueshme të vendeve fqinje.¹

Nga disa breza studiuesish është arritur që eposi shqiptar të trajtohet në një shumësi këndvështrimesh. Në këngët epike legjendare ka zëra e jehona prej shumë epokash parahistorike, prandaj ato vlerësohen si këngë me karakter shumështrësor. Në to nuk ka heronj historikë, por heronj kulturorë. Eposi i kreshnikëve është shprehja më e hershme e vetidentifikimit etnik të parashqiptarëve dhe shqiptarëve.² Ideja për të kërkuar Eposin e Kreshnikëve në kuadrin më të

madh gjeografik të vendeve kufitare ofron një perspektivë që zgjeron njohuritë e epikës shqiptare dhe shkon përtej mënyrës tradicionale të qasjes ndaj kësaj çështjeje.

Botimi *Gjurmime të eposit të kreshnikëve në Ballkan* (Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa vise të Ballkanit), është një paraqitje në vijimësi e përpjekjeve që eposi heroik legjendar shqiptar të shndritet dhe popullarizohet sa më shumë. Mënyra e strukturimit të veprës është interesante për lexuesin e studiuesit e fushës veçanërisht, por edhe më gjerë.

Si fillim, ndalet tek Eposi i Kreshnikëve në fonde arkivore të Universitetit të Harvardit (2002-2020) mandej, kalon në specifikime - Eposi i Kreshnikëve të Sanxhakut të Pazarit të Ri në vitet '30 të shekullit të kaluar, në fonde arkivore në Universitetin e Harvardit; në krahinën e Plavës dhe Gucisë; në krahinën e Rugovës dhe së fundmi në krahinën e Mërturit.

Interes paraqet edhe pjesa kur flet për fillet e interesimit për epikën gojore shqiptare në

¹ Z. Neziri, "Gjurmime të eposit të kreshnikëve në Ballkan". (Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa

vise të Ballkanit), Prishtinë-Tiranë, 2023, f. 15

² Sh. Sinani, Etnos në epos, Tiranë, 2011, f. 11

Harvard, duke filluar me Francis James Child, (profesor i Retorikës dhe Oratorisë), i cili konsiderohet si filluesi i studimeve të folklorit në Harvard, duke filluar qysh nga viti 1856, Millmen Peri, George Lyman Kitredge (formulues i parimeve të para të Teorisë Gojore), Allbert Llord, David Bynum, etj. Studime në fushën e folklorit organizohen edhe sot në Harvard, në Komitetin e Degës së Folklorit dhe Mitologjisë, drejtuar nga Stephen Mitchell.

Në veçanti nënvizon projektin e prof. Millmen Perit të Universitetit të Harvardit, *Projekt për studimin e poezisë popullore gojore jugosllave*, hartuar më 1933, ku në kuadër të tij është përfshirë edhe poezia popullore gojore shqiptare, kryer në vitet 1934-1935. Ndihej prej Allbert Llord, Peri shënoi në Ballkanin Perëndimor mbi 12 mijë tekste dhe i incizoi në rreth 3500 pllaka gramafoni. Më 1937, me këngët epike të shënuara nga A. Llordi u krijua koleksioni më i madh i eposit heroik shqiptar, i mbledhur nga studiues të huaj, që ruhet në kuadër të Koleksionit të M. Perrit.

Rapsoditë e Eposit të kreshnikëve janë këngë me pavarësi formale nga njëra-tjetra,

por që në përmbajtje i bashkon e njëjta mendësi, e njëjta epokë, e njëjta hapësirë, të njëjtat figura mitologjike e gjysmëmitologjike.

Interes paraqet edhe kapitulli i dytë ku ndalet dhe shpjegon rezultatet e punës kërkimore në Gadishullin Ballkanik (G. Ilirik) lidhur me Eposin e kreshnikëve për vitet 2012-2020. Konkretisht në Krajë; në Malësinë e Madhe, në Llapushë; në Drenicë; në Gostivar me rrethinë dhe në Kërçovë me rrethinë. Të gjitha këto, si rezultat i një pune madhore kërkimore shkencore në kuadër të Projekti E5 në Ballkan.

Jo vetëm në botimin e fundit të prof. Zymerit, por edhe në shumë të tilla simotra, e shohim eposin e shqiptarëve si një traditë të pandashme prej dukurive të tjera të rëndësishme historiko-kulturore, me rëndësi në formimin e etnosit shqiptar: jeta urbane, tradita e shkrimeve të vjetra, dëshmitë e udhëpërshkruesve dhe misionarëve të huaj, burimet dhe bibliografitë. Kulti i malit, i bjeshkës, i lartësisë; përdorimi i kohës për të matur hapësirën dhe anasjelltas; tipi i mendimit poetik; janë shprehje e një hershmërie dhe vijueshmërie të gjatë. Ndaj me të drejtë në shumë studime rreth kësaj teme thuhet

me bindje se Eposi i kreshnikëve është përmendorja më e rëndësishme e trashëgimisë gojore iliro-shqiptare që dëshmon mitologjinë e hershme të popullit shqiptar.

Sigurisht, nuk mund të mbeteshin jashtë këtij punimi e projekti njëkohësisht edhe bartësit, ata që bëjnë të mundur ekzistencën e kësaj kulture kaq madhështore, Eposit të kreshnikëve. Në epos krijuesi dhe bartësi i rapsodive dallojnë veten prej tjetrit si qenie etnike. Tjetri identifikohet edhe përmes etnonimit të vet: Shkjau, Harambashi, Harapi i Zi etj. Pavarësisht nga modifikimet e vazhdueshme që kanë pësuar, pavarësisht nga mënyra se si paraqiten në trajtën e tyre përfundimtare kur janë mbledhur, këngët e Ciklit të Kreshnikëve janë ngjizur me një substancë të lashtë. Lahutarët shqiptarë janë të bindur se kënga, të kënduarit e këngëve kreshnike nuk janë argëtime të thjeshta, por ai synon të përjetësojë lavdinë e heronjve.

Pjesa e tretë e veprës i dedikohet pikërisht portreteve të rapsodëve të njohur të Rrafshit të Dukagjinit si Halil Beka-Mehmetaj e Bajrush Doda, të dy nga rrethinat e Pejës, lindur në

gjysmën e parë të shekullit XX dhe shumë të përmendur për këndimin epik.

Në këtë mënyrë, epikën gojore, Eposin e kreshnikëve e ka trajtuar jo vetëm si enciklopedi të mendimit estetik të qëmoçëm, si përmendore e kulturës kombëtare, si pasqyrën e universit shqiptar në kohë që “s’mbahem mend”, por edhe si biografi krijuese e brezave që e kanë ruajtur, trashëguar, përpunuar dhe sjellë në gjendjen e riprodhimit folklorik letrar të pranishëm në qarkullimin e vlerave të tij, çka dëshmon për një njohje e zotërim shumë të mirë të fushës, traditës, duke tejkaluar shkallën e arritur. Madje, prof. Zymeri nuk lë pa përmendur edhe studiuesit tanë të etnokulturës si: Qemal Haxhihasani, Andromaqi Gjergji, Alfred Uçi, Demush Shala, Enver Mehmeti, Shaban Sinani etj., të cilët kanë dhënë ndihmesë me rëndësi, lidhur me vlerat artistike dhe me jehonën poetike në eposin tonë heroik legjendar të ndeshjeve e përgjakjeve iliro- arbërore me sllavët e Jugut të ardhur në Iliri dhe me shtrirjen e tyre kohore në histori, për

elementet mitike, për heronjtë mitikë etj.³

Në veprën studimore *Gjurmime të eposit të kreshnikëve në Ballkan* (Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa vise të Ballkanit), një rol të veçantë luajnë edhe shënimet bibliografike, referencat bibliografike, burimet bibliografike, literaturat e rekomanduara, emrat e lahutarëve, vendbanimet përkatëse të tyre, si dhe përfundimet, të cilat krijojnë një panoramë më të plotë për Eposin e kreshnikëve si monument i trashëgimisë kulturore shqiptare.

Në mbyllje, do të theksoja me bindje të plotë se, prof. Zymer Neziri është vetëm një njohës shumë i mirë i pasurisë, trashëgimisë kulturore, eposit heroik shqiptar, shpirtit, teknikës së krijimit, i jetës dhe qarkullimit të saj, i variantit kohor dhe hapësinor, i figurave

që lëvizin në të, por dhe një studiues skrupuloz që e transmeton bukur dhe shkencërisht dijen mbi Eposin e kreshnikëve, çka na bën të themi me bindje se, nuk po flasim për një njohje të thjeshtë, por për një përvetësim deri në detaje.

Formimi i shumanshëm, erudicioni, serioziteti, veprimtaria e gjatë dhe rezultative, ndjenja e përgjegjësisë shkencore dhe afësia për të dialoguar vazhdimisht me mendimin e gjerë shkencor, i kanë dhënë prof. Zymer Nezirit një vend të nderuar e të merituar. Edhe botimi *Gjurmime të eposit të kreshnikëve në Ballkan* (Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa vise të Ballkanit), përforcon këtë mendim, madje, dëshmon një nivel shumë të lartë, duke pasuruar ndjeshëm studimet albanologjike.

Merita Gjokutaj - Shehu

³Z. Neziri , “Gjurmime të eposit të kreshnikëve në Ballkan” (Kërkime në fonde arkivore të Harvardit dhe në disa

vise të Ballkanit), Prishtinë-Tiranë, 2023, f. 59